



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektvendim “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti s.p.a.*, për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”.
3. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015.
4. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar” ratifikuar me ligjin nr. 89/2015”.
5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Bashkim Fino, Bledar Çuçi.

Të ftuar:

Besnik Dervishi - Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Gelardina Prodani - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhambi – drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vilma Çausholli - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj - drejtor i Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi - drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Anduena Hoxha - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazexhi – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Luljeta Dauti – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Artan Shkreli, - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilir Bejtja - këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimio Plaku – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bashkim Kasoraho - Njësia e Zbatimit të Projektit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ani Dyrmishi - Administrator i HSH në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pina - specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Mediet të futen brenda!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Meqenëse kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me rendin e ditës, ku sot do të shqyrtojmë 5 çështje.

Çështja e parë është projektvendimi “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relatore e këtij projektvendimi është zonja Vasilika Hysi. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Besnik Dervishi, Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndërsa nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë zonja Vilma Çausholli, përgjegjëse sektori.

Fjalën do t’ia jap zotit Dervishi për të na bërë një prezantim të shkurtër të projektvendimit për kolegët deputetë, por edhe për opinionin publik dhe më pas fjalën do ta ketë zonja Hysi.

Besnik Dervishi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Siç jeni edhe në dijeni, me ligjin nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, zyrës së Komisionerit i janë shtuar në numrin e përgjithshëm të punonjësve dy punonjës në cilësinë e inspektorëve. Zyra e Komisionerit ka një strukturë që është Struktura për të Drejtën e Informimit, e cila që prej krijimit të saj ka mbetur e paplotësuar dhe të dy këta punonjës shtesë janë menduar që të plotësojnë strukturën e Drejtorisë për të Drejtën e Informimit, e cila nga një drejtor dhe një inspektor, plotësohet me një drejtor dhe pesë inspektorë.

Në të njëjtën kohë duke përfituar nga ky ndryshim jemi përpjekur të bëjmë edhe disa rregullime të vogla në strukturë, për të unifikuar strukturën e këtij institucioni të pavarur në të njëjtën nivel dhe standard me institucionet e tjera të pavarura të krijuara me ligj që kanë të bëjmë me specialistin e buxhet-financës, me specialistin e protokoll-arkivës që kryen edhe detyrën e redaktorit dhe me dy specialistë të Drejtorisë Juridike, të cilët janë pjesë e Sektorit të Procedurave Administrative dhe me hyrjen në fuqi të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” kryejnë detyrat e inspektimit që i është caktuar me këtë ligj Zyrës së Komisionerit. Shkurtimisht këto janë ndryshimet e propozuara. Unë mendoj që nuk ka asnjë pengesë, sepse edhe nga ana financiare janë

të gjitha të përlogaritura brenda buxhetit të vitit 2018, pra nuk ka asnjë efekt financiar dhe nuk kërkohet asnjë fond shtesë për sa u përket këtyre rregullimeve në strukturë. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishi!

Fjala për zonjën Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Për sa i takon kërkesës së bërë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Shërbimet e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura pranë Kuvendit të Shqipërisë kanë bërë një studim, ku kanë vlerësuar strukturën, rezolutën që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë dhe detyrat që ka lënë për Komisionerin dhe stafin e tij, njëkohësisht edhe gjithë praktikën e komunikimit midis Zyrës së Komisionerit dhe Zyrës së Administratës Publike.

Në fakt, ka pasur një komunikim midis Zyrës së Komisionerit dhe Departamentit të Administratës Publike, ku ky departament edhe në përgjigje të kërkesës që ka bërë Komisioneri, ka shprehur mendimin se është dakord për ndryshimet e propozuara, shkresa mban datën 14 maj 2018, me numër protokolli 3413/1, ndërkohë që të gjithë anëtarët e komisionit e kanë përpara shkresën.

Gjithashtu, Ministria e Financave është shprehur dakord për ndryshimin që propozohet në strukturë, duke akorduar edhe fondin e shpenzimeve të personelit prej rreth 37 punonjësish. Ajo që do të doja të theksoja në cilësinë e relatores është se jam dakord, pasi në këtë mënyrë Komisioneri do të përmbushë edhe atë çfarë është thënë në progres-raportin e Bashkimit European, si dhe duhet të bëjë më shumë përpjekje për përmirësimin dhe hartimin e legjislacionit në përputhje me rregullat e përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave personale dhe direktivën e fundit gjë, të cilën ia kemi lënë edhe si detyrë në rezolutën që kemi miratuar pak ditë më parë.

Unë ju sugjeroj kolegëve ta miratojnë propozimin. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Ne, në fakt, i jemi drejtuar edhe Departamentit të Administratës Publike dhe besoj se janë marrë në konsideratë propozimet e bëra nga ky departament dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuesit e të cilës janë prezent sot në komision.

Fjalën e ka kërkuar zoti Braho.

Spartak Braho – Nuk kam ndonjë gjë esenciale për të thënë, pasi jam dakord.

Në fakt, jemi përpara një veprimi tipik burokratik tërësisht të panevojshëm. Nuk e kuptoj arsyen pse ne duhet të miratojmë një ligj, një dispozitë, për të shtuar dy njerëz në organikën e Zyrës

së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi kjo është një gjë tërësisht burokratike dhe ne duhet të çlirohemi nga këto hallka.

Kjo ishte diçka sa për thënë sepse nuk mund ta zgjidhim sot.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Braho ka shumë të drejtë, sepse duhet të jemi sa më pak burokratik, por organika e Zyrës së Komisionerit është miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë, konkretisht me vendimin nr. 106 të vitit 2014 e për rrjedhojë duhet përsëri me vendim që ne të bëjmë ndryshimin e strukturës dhe të organikës, kjo është arsyeja. Ndoshta në të ardhmen mund të shohim se si mund të lehtësohen procedurat, por për aq kohë sa ka një vendim ndryshimi duhet bërë në vendim dhe ky është një detyrim që buron nga ligji nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat dhe shpërblimet e strukturave të institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

A ka pyetje dhe diskutime për projektvendimin? Nuk ka.

Hedhim në votim projektvendimin. Kush është pro projektvendimin “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”? Kundër? Abstenim?

Miratohet projektvendimi “Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i cili më pas do t’i kalojë seancës plenare.

Faleminderit zoti Dervishi dhe ditë të mbarë!

Besnik Dervishi – Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti s.p.a.*, për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Bashkim Fino, Bledar Çuçi.

Të ftuar:

Tedi Bushaj - drejtor i Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi - drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Anduena Hoxha - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazexhi – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Luljeta Dauti – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ulsi Manja – Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.*, për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”. Komisioni i Ligjeve për këtë projektligj është komision për dhënie mendimi dhe relatore është zonja Vasilika Hysi.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë zoti Tedi Bushaj, drejtor i Borxhit Publik. A është prezent zoti Bushaj? Zonja Majlinda Hafizi...

Kush ka ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë projektligj, do t’ju lutesha kur ta merrni fjalën të prezantoheni, sepse të tjerë na konfirmohen se do të jenë të pranishëm dhe të tjerë vijnë në komision.

Shkurtimisht për kolegët dhe opinionin publik fjalën e kanë përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të na bërë një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje.

Ju lutem, prezantohuni!

Stavri Lako – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë quhem Stavri Lako, përgjegjës në Sektorin e Arsimit dhe Formimit Profesional në Drejtorinë e Politikave të Punësimit dhe Arsimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ulsi Manja – Më falni, si e kishit emrin?

Stavri Lako – Stavri Lako.

Ulsi Manja – Zoti Lako, unë s’e kam fare emrin tuaj këtu të konfirmuar, dakord!

Ky është komunikimi që sekretaria e komisionit ka me ministrinë respektive dhe unë kam këtu 5 emra të tjerë.

Mund të vazhdoni me prezantimin e projektligjit, por do t’ju lutesha që herët e tjera, sepse nuk dua ta ndërpres mbledhjen e komisionit, për respekt të kolegëve, por edhe të marrëveshjeve që janë fiksuar në kalendarin e punimeve të Kuvendit, por nuk do të pranoj më mbledhje komisioni në rast se në nivelin e përfaqësimit nuk janë zëvendësministër e lart. Ju mund t’ia transmetoni kabinetit të ministrit, sepse kjo është çështje serioziteti dhe vlerësimi që i bëhet Komisionit të Ligjeve.

Pra, mbledhjen e sotme po e vazhdoj në respekt të kolegëve dhe të seancës plenare që ka përcaktuar si rend dite këtë kalendar, por jo për nivelin e përfaqësimit. Me gjithë respektin që kam

për ju, diskutimi në këtë komision është i nivelit politik. Ju jeni shumë të nderuar dhe të respektuar për detyrën që kryeni, por ky është një komision ku diskutimi fillimisht është i nivelit politik.

Fjala për ju.

Stavri Lako – Faleminderit, zoti kryetar!

Patjetër që shqetësimin tuaj do t'ua përcjellim eprorëve tanë.

Shkurtimisht, dua t'ju flas për fushën e arsimit dhe formimin profesional dhe më vonë kolegu im do të ndalet në termat teknike të projektligjit. Siç e dini, arsimi dhe formimi profesional është një nga prioritetet e qeverisë, si dhe një ndër kolonat bazë të strategjisë kombëtare të punësimit dhe të aftësive 14-20. Për këtë arsye vitet e fundit qeveria ka rritur ndjeshëm investimet konkretisht në rikonstruksionin e shkollave në bashkëpunim me biznesin, hartimin e kurrikulave në funksion të tregut të punës, si dhe është rritur ndjeshëm edhe mbështetja e donatorëve. Në këtë kuadër bashkëpunimi, duke u bazuar edhe në protokollin e bashkëpunimit me qeverinë italiane, është rënë dakord për financimin me një kredi të butë të dy shkollave në qytetet e Fierit dhe të Lushnjës. Baza e kryesore e kredisë prej 4,5 milionë eurosh do t'i dedikohet qytetit të Fierit, për rikonstruksionin e ambienteve, blerjen e pajisjeve, trajnimin e mësuesve, hartimin e kurrikulave, ndërsa pjesa tjetër prej 500 mijë eurosh do t'i dedikohen shkollës së qytetit të Lushnjës. Teknikisht është negociuar, sepse marrëveshja teknike është miratuar vjet nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe kjo marrëveshje financiare ka ardhur, por kolegu mund t'jua sqaroj teknikisht këto probleme financiare.

Ulsi Manja – A është e nevojshme, zonja Hysi, të na sqarohet teknikisht nga ana e ministrisë për marrëveshjen?

Ju lutem, përfaqësuesi i ministrisë sa më shkurt!

Stavri Lako – Financimi që akordohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ka terma shumë të mirë, kemi një shumë prej 5 milionë eurosh me afat maturimi 22 vjet dhe 10 vjet pa pagesë principali. Është një kredi e butë me normë interesi zero, e cila për qeverinë shqiptare besoj se është...

Ulsi Manja – Është një marrëveshje e leverdishme për qeverinë.

Faleminderit!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo marrëveshje financiare është shumë e rëndësishme për shkak të problematikës që rregullon, adreson programin e aftësimit dhe të formimit profesional nëpërmjet inovacionit. E kam lexuar me vëmendje marrëveshjen dhe do të doja t'ju bëja 2-3 pyetje për relacionin.

Marrëveshja është me rendësi, por vazhdimisht në komision kemi ngritur një shqetësim për relacionet që hartohen dhe kemi kërkuar, pavarësisht se këto marrëveshje janë pa interes, janë shumë të leverdishme e të tjera, të ketë të dhëna lidhur me impaktin, me përfituesit. Pra, cilët janë përfituesit dhe sa është numri i tyre, qoftë në shkollën e arsimimit dhe të formimit profesional në Fier apo edhe në Lushnjë?

E dyta, kjo është një marrëveshje, e cila bazohet në një marrëveshje të mëparshme të ratifikuar dhe nuk kemi asnjë informacion se çfarë është bërë me grantin ose me marrëveshjen, i cili ka qenë e nënshkruar më parë, pavarësisht se mund të jetë me zero interes, por Kuvendi i Shqipërisë, sidomos Komisioni i Ligjeve duhet t'i monitorojë dhe të dijë impaktin e këtyre marrëveshjeve. Në relacion në faqen 3 ju thoni: "Autoritetet shqiptare, ndërmarrjet italiane, si dhe asistencë teknike mund t'i ofrojnë shkollës...". Pra, nuk është e sigurt që do t'ua ofrojnë kur thoni "mund"? Këtë pikë e keni lënë shumë evazive.

Flisni për trajnime, për gjetje pune, sa trajnime ndërkombëtare do të ofrohen, kush do t'i ofrojë. Kur flisni për gjetje pune, e keni fjalën për në Shqipëri apo për jashtë vendit?

Pra, ne formojmë profesionistë në Shqipëri për t'i dërguar më pas në ndërmarrjet e huaja apo formojnë profesionistë për bujqësinë, për sektorin e përpunimit agro-ushqimor dhe do t'i punësojmë në Shqipëri? Cila do të jetë metoda e gjetjes së punës? Pse duhet të paguajmë para për gjetje pune? Unë këtë nuk arrij ta kuptoj, pasi ju keni vënë si komponent "gjetje pune".

Gjithashtu, për marrëveshjen, ndonëse kjo marrëveshje është nënshkruar këtë vit me vendimin nr. 195, ende vazhdon Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale. Ne nuk e kemi më një ministri të tillë, a e keni menduar si do të adresohet kjo? Këtë pyetje e kam për zotin Bushi, pasi kjo ministri nuk ekziston më, është shkrirë.

(Diskutime pa mikrofon)

Në këtë kuadër do t'ju sugjeroja të amendoni marrëveshjen qeveritare dhe jo ta përsërisnit përsëri këtë marrëveshje me një terminologji që nuk i qëndron më kohës. Pra, për sa i takon pyetjeve që ju bëra, do të doja një përgjigje.

Teksti i marrëveshjes është i përkthyer në shqip dhe i certifikuar, por do të ishte mirë që Kuvendit të Shqipërisë t'i vinte marrëveshja shqip-anglisht. Kryetarit të komisionit do t'ju sugjeroja

që këtë shqetësim t'ia adresonte Këshillit të Ministrave që çdo marrëveshje që vjen duhet të jetë shqip-anglisht. E para.

E dyta, relacionet duhet të përmbajnë informacion për impaktin social që ka çdo marrëveshje, çdo projektligj dhe të mos harrojmë që ne kemi nënshkruar axhendën e vitit 2030 dhe në këtë marrëveshje, në relacionin e saj, duhet të kishte të dhëna të detajuara për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Me cilin objektiv përkon kjo marrëveshje? Cilët janë indikatorët, treguesit që përmbushen nga axhenda 2030? Cilat janë rezultatet që ne do të arrijmë deri në vitin 2020 që Kuvendi ta dijë kur të miratojë marrëveshje të tjera se çfarë do të kërkojë dhe si mund ta monitorojë qeverinë?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Ju lutem, përgjigjuni pyetjeve dhe më pas do të kalojmë në votimin e marrëveshjes!

Stavri Lako – Për sa i takon impaktit sugjerimi është shumë i drejtë, ne duhet ta kishim parashikuar në relacion. Normalisht, duke iu referuar të dhënave aktuale në të dyja shkollat plus-minus janë rreth 1 mijë nxënës që ndjekin drejtimet që ofrojnë këto shkolla, 430 nxënës janë në shkollën e Fierit dhe 520 nxënës janë në shkollën e Lushnjës. Synohet që me ndërhyrjen që do të bëjë projekti, i cili ende nuk ka filluar të zbatohet dhe sugjerimi që ju bëtë për ecurinë, ne ende nuk mund t'ju raportojmë, sepse projekti nuk ka filluar të zbatohet, pasi pala italiane pret të bëhen këto procedura dhe të fillojë zbatimi i projektit.

Ne synojmë që me vënien në zbatim të projektit të rritet numri i nxënësve si në shkollën e Fierit ashtu edhe atë të Lushnjës. Përpos kësaj presupozohet që të dyja shkolla ashtu siç është tendenca e viteve të fundit të kthehen në qendra shumëfunktionale. Pra, përveç drejtimeve arsimore afatgjata, siç i quajmë ne, të cilat shkojnë deri në 4 vjet shkollim i nxënësve, këto institucione arsimore të mund të ofrojnë edhe kurse afatshkurtra për personat në nevojë, si për shembull, zonën e Çlirimit, ku kryen aktivitetin e saj shkolla e Fierit dhe në Lushnjë për drejtimet që ato ofrojnë, si për të papunë apo individë të tjerë që kanë nevojë. Pra, përpos afektimit të të rinjve do të afektohen edhe punë-kërkues të papunë apo edhe individë të tjerë që kanë nevojë,

Sugjerimi i ndryshimit për ish-Ministrinë e Mirëqenies Sociale, është mëse i saktë dhe i drejtë dhe ne do ta marrim nismën për ta ndryshuar dhe amenduar ligjin, pasi këtë gjë e ka konstatuar edhe pala italiane.

Vasilika Hysi – Këtë marrëveshje Kuvendi do ta ratifikojë midis Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale apo midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë?

Stavri Lako – Kjo është një marrëveshje financiare, janë dy gjëra të ndryshme...

Vasilika Hysi – Megjithatë palët, thuhet në marrëveshje, më falni që ju ndërhyra, por në nenin 1 thuhet “Përkufizime dhe interpretime” dhe në qoftë se këto shkojnë, ju keni përkufizuar Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në Republikën e Shqipërisë. Marrëveshja daton prillin e 2018-ës, ndërkohë qeveria ka ardhur në shtator të...

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni, por Kuvendi nuk mund ta ratifikojë me këtë emër, sepse është nënshkruar në prill të 2018-ës dhe kjo ministri në këtë periudhë nuk ka ekzistuar. Si e keni nënshkruar, si Ministri e Financave apo si Ministri e Mirëqenies dhe e Rinisë...?

(Diskutime pa mikrofon)

Në të thuhet: pasues është Agjencia Ekzekutive e Programit dhe do të përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe e Mirëqenies nuk ekziston më.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

A ka pyetje të tjera nga kolegët për marrëveshjen?

Po, zonja Bushka, ka një pyetje.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje. Në momentin e realizimit të huas, për sa kohë është parashikuar ndërtimi dhe vënia në funksion e shkollave të reja?

Stavri Lako – Këto janë elemente teknike, që janë pasqyruar në...

Klotilda Bushka – Nuk janë në marrëveshje, sepse marrëveshja parashikon vetëm kushtet e kredisë.

Stavri Lako – Është në marrëveshjen e parë teknike, që është miratuar nga ana e Kuvendit vitin e kaluar.

Klotilda Bushka – Ju nuk e thoni dot, nuk keni ide të përafërt?

Stavri Lako – Po, rreth 3-4 vjet, aq zgjasin këto...

Ulsi Manja – Për marrëveshjen tjetër që ne kemi votuar kanë qenë përfaqësues të tjerë të ministrisë dhe nuk ka se si...

A ka pyetje? Nuk ka.

A ka diskutime nga kolegët? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të marrëveshjes.

Kush është dakord në parim për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe *Cassa Depositi e Prestiti s.p.a.*, për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim kjo marrëveshje!

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të kësaj marrëveshjeje.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në tërësi në votim projektligjin me sugjerimet përkatëse të bëra lidhur me ndryshimin e terminologjisë së ministrisë që suprimohet dhe ministrisë tjetër, që merr atributet e kësaj ministrie. Kush është pro? Kundër abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe *Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.*, për programin e arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet inovacionit”.

Relatorja dhe këshilltarët të bëjnë gati raportin, i cili, së bashku me mendimin tonë, do t’i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Bashkim Fino, Bledar Çuçi.

Të ftuar:

Tedi Bushaj - Drejtor i Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi - Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Anduena Hoxha - përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Brikena Jazexhi - specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, në diskutimin e projektligjit “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015”.

Edhe për këtë marrëveshje jemi komision për dhënie mendimi. Relatore është kolegja Elena Xhina.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë...

Ju lutem prezantohuni!

Majlinda Hafizi – Quhem Majlinda Hafizi, jam drejtore e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hafizi!

Meqenëse jeni përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, edhe për ju vlen i njëjti sugjerim, që sa herë të keni njoftime nga Komisioni i Ligjeve për t’u paraqitur në komision dhe nuk do të jeni e shoqëruar, të paktën në nivelin e përfaqësimit politik të zëvendësministrit, do të duhet të refuzoni ardhjen në komision, sepse nuk do t’ju lejojmë të merrni pjesë në mbledhje. Kjo është e qartë. Do t’i nis edhe një shkresë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, por edhe Këshillit të Ministrave për këtë.

Për kolegët, një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje, fjala është për ju.

Majlinda Hafizi – Faleminderit, të nderuar!

Po bëj një përmbledhje të shkurtër të historikut të kësaj marrëveshjeje, e cila në kuadrin e protokollit të bisedimeve qeveritare që prej muajit maj 2010, në kuadrin e nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi financiar midis qeverisë shqiptare dhe gjermane, u arrit që më 6 korrik të ratifikohet në parlament me ligjin nr. 86, 6 korrik, 2015, marrëveshja e bashkëpunimit financiar 2010 për zbatimin e dy projekteve. Njëri projekt ishte për rifinancimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë, që e mbulonte Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe projekti tjetër, efienca energjetike nëpërmjet sistemit bankar, të cilin do ta diskutojnë përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Për sa i përket projektit të parë, arsyeja pse kërkohet denoncimi i kësaj marrëveshjeje është sepse kjo marrëveshje që në fillim u nënshkrua pa bërë një studim fizibiliteti për të nxjerrë edhe nevojat e tregut apo edhe të vetë FME-ve, (ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme).

Së dyti, Banka Gjermane për Rindërtim, KfW-ja, e cila ishte kontraktuar për disbursimin e fondeve, negocioi me të gjitha bankat e nivelit të dytë dhe arriti në konkluzionin që asnjë nga bankat nuk kishte nevojë për likuiditete, për kredi, por mbi të gjitha lindi nevoja e një fondi garancie për të minimizuar riskun e kthimit të kredive. Kjo ishte arsyeja pse kjo marrëveshje nuk u zbatua kurrë, nuk u bë eficiente dhe nuk u mor asnjë kredi, asnjë fond nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Nisur nga ky fakt, u bënë disa negociata me ministren e Ekonomisë, zonjën Ekonomi, dhe u rakordua që do të bëhej një studim ku të nxirrej nevoja e tregut për çfarë kanë nevojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe u konkludua se është i nevojshëm një fond garancie ,që nuk parashikohet në termat e këtij projekti apo kësaj marrëveshjeje. Pala gjermane rakordoi me palën shqiptare dhe u dakordësuan për anulimin, apo le të përdorim termin juridik, denoncimin e kësaj marrëveshjeje, për t'i lënë hapësirë mundësisë së rivitalizimit të kësaj marrëveshjeje me Ministrinë e Bujqësisë për rifinancimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për zonat rurale nëpërmjet krijimit të një fondi garancie të kredive rurale.

Kaq kisha! Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hafizi.

Fjala për zonjën Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonjë, për prezantimin!

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit jemi duke diskutuar projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015”.

Kjo marrëveshje është lidhur më 6 korrik të vitit 2015 dhe, siç u prezantua nga zonja në fjalë, për vet faktin se në këtë marrëveshje nuk është parashikuar një instrument, që ishte garancia që duhej parashikuar në kushtet e marrëveshjes, si pasojë ka sjellë moszbatimin e saj.

Marrëveshja bënte fjalë për një financim prej 5 milionë eurosh, e cila do të promovonte ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale. Jemi para kushteve ku denoncohet kjo marrëveshje në përputhje me ligjin nr. 43/2016, ku Republika e Shqipërisë mund të tërhiqet nga një marrëveshje ndërkombëtare. Me sa kuptoj, po këto terma marrëveshjeje dhe po kjo shumë do të rilidhen përsëri nëpërmjet marrëveshjes që është bërë nëpërmjet kanaleve diplomatike me shtetin gjerman.

Majlinda Hafizi – Vetëm duke ndryshuar termat e referencës së projektit për të krijuar...

Elena Xhina – Duke parashikuar edhe faktin që solli këtë pasojë.

Në këto kushte, tërheq vëmendjen që herë tjetër të jenë më të kujdesshëm në lidhjen e marrëveshjeve duke parashikuar të gjitha teknikalitetet e duhura që të mos arrijmë në këto përfundime për të bërë denoncime, sepse kemi njerëz që vihen në punë, kemi shpenzime, etj. Në këto kushte, i propozoj komisionit që ta miratojë këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Nëpërmjet denoncimit zgjidhet një kontratë, e cila ka qenë në fuqi dhe nuk është realizuar. Fondi kalon në kuadër të një marrëveshjeje tjetër, në një fushë tjetër. Pra, ne do të kalojmë nga fusha e eficiencës energjetike të ndërtesave në zona rurale dhe urbane, në fonde për bujqësinë.

Majlinda Hafizi – Që t’jua sqaroj, në kuadër të kësaj marrëveshjeje janë dy projekte: është financimi prej 5 milionë eurosh, projekti i FME-ve që i kalon bujqësisë, përsëri për FME-të.

Klotilda Bushka – Po pra, por për bujqësi, jo për eficiencë energjetike!

Majlinda Hafizi – Ky është projekt tjetër prej 7 milionë eurosh për energjinë, për të cilin do të përgjigjen ata vetë.

Klotilda Bushka – Fondi që parashikohej në kontratën që është zgjidhur dhe sot denoncohet, se “denoncim” do të thotë “zgjidhje”, në kuadrin e termave të marrëveshjes, i cili ishte planifikuar për eficiencën e energjisë, nuk do të përdoret më për të?

Majlinda Hafizi – Në dijeninë time, sipas raportimit të djeshëm të përfaqësuesve të Ministrisë së Energjetikës do të kalojë te Ministria e Bujqësisë për rifinancimin e FME-ve nëpërmjet fondit të garancisë për kredinë rurale.

Klotilda Bushka –Atëherë duhet të flasim me përfaqësuesit e Ministrisë së Energjetikës.

Majlinda Hafizi – Ata do të vijnë të bëjnë denoncimin për pjesën e projektit të vet.

Klotilda Bushka –Atëherë, një pyetje për ju: denoncimi i kësaj marrëveshjeje, për sa ju takon juve, ka penalitete për ne?

Majlinda Hafizi – Nuk ka asnjë penaltitet, asnjë konsum apo shpenzim. Asnjë moment nuk është bërë disbursim fondesh dhe nuk janë parashikuar në ndonjë sanksion penalitete të kësaj natyre, sepse, në një farë mënyre, është edhe përgjegjësia e negocimit që në fillim nga palët dhe, mesa duket, ato i kanë evidentuar vetë hapësirat ligjore të kësaj marrëveshjeje.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hafizi!

Ka pyetje të tjera?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Hafizi!

Rezulton që kjo marrëveshje është nënshkruar në vitin 2015. Nuk e di sa informacion kemi, por në relacion thuhet se studimi në Shqipëri evidenton një pengesë të madhe për dhënien e kredive, që nuk është mungesa e mjetit financiar, por mungesa e garancive nga ana e kredimarrësve.

Kur është sjellë kjo marrëveshje në vitin 2015, a është mbajtur në konsideratë që kredimarrësit nuk kanë pasur garanci?

Majlinda Hafizi – E theksova që në fillim se mungesa e studimit të fizibilitetit përpara se të nënshkruhej kjo marrëveshje, e bëri të paefektshme këtë marrëveshje, ndaj u konkludua që në shtator të vitit 2017 të bëhej ky studim ku u dakordësua të krijohej patjetër një fond garancie, pasi bankat e nivelit të dytë nuk vuajnë për likuiditete, por për një shumë garancie. Pra, ndryshuan termat e projektit. Projekti i parë nuk kishte parashikuar fondin e garancisë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hafizi!

Ka diskutime nga kolegët?

E hedhim në votim në parim këtë projektligj. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim projektligji!

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nën për nen të këtij projektligji.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në votim në tërësi këtë projekt marrëveshje. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015”.

Ky projektligj së bashku me raportin e komisionit do t’i përcillet komisionit përgjegjës e më pas seancës plenare.

Faleminderit!

Ditë të mbarë, zonjë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin nr. 89/2015” zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Bashkim Fino, Bledar Çuçi.

Të ftuar:

Artan Shkreli - Zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
Ilir Bejtja - këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Enea Karakaçi -Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Thimio Plaku - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Bashkim Kasoraho – përfaqësues i Njesisë së Zbatimit të Projektit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ani Dyrmishi - administrator i HSH-së në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Anisa Pina – specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ulsi Manja - Vazhdojmë me çështjen e katërt të rendit të ditës, projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficiencia energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar me ligjin nr.89/2015”.

Edhe për këtë projektligj komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji është kolegu Jurgis Çyrbja. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zoti Artan Shkreli, zëvendësministër, së bashku me stafin e kësaj ministrie.

Zoti Shkreli, mirë se keni ardhur në komision!

Do t’ju lutesha të bëni shkurtimisht një prezantim të kësaj marrëveshjeje për kolegët e komisionit, për të vazhduar më pas me procedurat e miratimit të këtij projektligji, sipas Rregullores së Kuvendit!

Fjala për ju!

Artan Shkreli – Mirëdita!

Bëhet fjalë për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficiencia energjetike përmes sektorit bankar”. Ky është një ratifikim, i cili pothuajse është thellësisht teknik dhe i mbështetur në aktet paraardhëse.

Do t’ia kaloj fjalën kolegut tim, i cili në pikëpamje teknike, por edhe të teknikës legislative mund të japë dy parashtrës dhe sigurisht, mund t’u përgjigjemi pas pyetjeve që do të keni.

Enea Karakaçi - Përshëndetje!

Quhem Enea Karakaçi , jam drejtor Juridik në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Siç e prezantoi edhe kolegia e Ministrisë së Financave, në fakt, denoncimi i kësaj marrëveshjeje bëhet në vijim edhe të denoncimit të bërë dhe të propozuar nga Ministria e Financave. Paraprakisht, mund t’ju them se në vitin 2015, me anë të ligjit nr. 89/2015, është miratuar marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, që alokonte një hua prej 12 milionë eurosh me anë të KfW-së për eficiencën e energjisë.

Ishte parashikuar që këto të alokoheshin me anë të bankave të nivelit të dytë, ku ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të kishin mundësinë për të marrë hua me kredi të butë për investime në eficiencën e energjisë.

Ajo që u vu re në dy vjetët e shkuar ishte se bankat e nivelit të dytë nuk kishin nevojë për likuiditete financiare, por ajo çfarë shërbeu për mosrealizimin me sukses të kësaj marrëveshjeje ishte mungesa e garancive për kredimarrësit.

Në këtë kuptim, me anë të bashkëpunimit me Ministrinë e Jashtme, me Ministrinë e Financave, me Ministrinë e Bujqësisë, si dhe kërkesën insistuese të Ambasadës Gjermane, u pa e arsyeshme që të denoncohej kjo marrëveshje dhe të alokohej nga grant prej 5 milionë eurosh për sektorin e bujqësisë, ku të mundësohej garancia e kredimarrësve me anë të fondit të krijuar rishtazi për garancitë e kredive rurale.

Si e tillë, ashtu si edhe marrëveshja e mëparshme, që prezantoi Ministria e Financave, me anë të këtij projektligji synohet denoncimi i marrëveshjes së vitit 2015.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Karakaçi!

Fjalën e ka relatori.

Jurgis Çyrbja – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i këtij projektligji është denoncimi i marrëveshjes së bashkëpunimit financiar 2010, të nënshkruar në vitin 2015 për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, ratifikuar në vitin 2015 ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij projektakti synohet tërheqja nga marrëveshja, e cila vlerësohet të jetë e pazbatueshme dhe në këtë mënyrë t’i hapet rruga nënshkrimit të një marrëveshjeje të re për mbështetjen e projektit të promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë gjermane të kredive rurale.

Shkak për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje ka qenë fakti se për shkak të likuiditetit të lartë të sektorit financiar shqiptar, rezultoi se kjo nismë nuk ishte efiçente për bankat shqiptare, kjo, pasi në Shqipëri, sipas palës gjermane, pagesa më e madhe për dhënien e kredive nuk ishte mungesa e mjeteve financiare, por mungesa e garancive nga ana e kredimarrësve.

Në aspektin ligjor vlerësoj se ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi. Nga ana procedurale është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Në këto kushte kërkoj votimin nga ana e anëtarëve të komisionit.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Çyrbja!

Ka pyetje dhe diskutime nga kolegët?

Kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen të këtij projektligji.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015”.

Zoti Çyrbja, ky projektligj së bashku me relacion t’i kalojë komisionit përgjegjës e më pas votimit në seancë plenare, sipas kalendarit të përcaktuar në punimet e Kuvendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët European i Ballkanit Perëndimor”

zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Bashkim Fino, Bledar Çuçi.

Të ftuar:

Artan Shkreli - Zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilir Bejtja - këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimio Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Bashkim Kasoraho - përfaqësues i Njësisë së Zbatimit të Projektit në Ministrinë e
Infrastrukturës dhe Energjisë

Ani Dyrmishi - administrator i HSH-së në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pina - specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e pestë dhe të fundit të rendit të ditës, që është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët European i Ballkanit Perëndimor”.

Edhe për këtë projektligj komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është zoti Edmond Leka. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zoti Artan Shkreli së bashku me stafin e ministrisë përkatëse.

Zoti Shkreli, fjala është për ju për një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje.

Artan Shkreli – Ju falënderoj!

Gjej rastin t’ju përshëndes edhe një herë të gjithëve, në mënyrë të veçantë kryetarin, që e drejton këtë mbledhje me kaq profesionalizëm.

Jemi mbledhur këtu për të diskutuar propozimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – U lutem kolegëve të mbajnë qetësi, sepse nga të gjitha marrëveshjet që kemi shqyrtuar sot, kjo marrëveshje ka vëmendjen e opinionit publik, sidomos për banorët e dy qarqeve: Tiranë dhe Durrës.

Artan Shkreli – Në fakt, pavarësisht se nuk jemi aty ku duhet me rehabilitimin e sistemit hekurudhor shqiptar, këtu bëhet fjalë për synimin që ky grant ka në lidhje me përmirësimin e trasesë ekzistuese Tiranë-Durrës, në një gjatësi prej 34 kilometrash, si dhe degëzimit në aeroportin e Rinasit për ta bërë funksional vajtjen e pasagjerëve në Rinas. Gjithashtu, flitet edhe për ndërtimin e një terminali të ri në ish-stacionin e trenit të Tiranës, të cilit në planet rregulluese dhe ndërhyrjet e mëparshme i kishin eksploduar ndërtimin e një terminali në afërsi të Unazës së Tiranës.

Në këtë marrëveshje synohet për rindërtimin e një terminali vetëm për pasagjerët që do të lehtësojë qarkullimin e njerëzve nga qendra e Tiranës. Plani i mëtejshëm është për një *late really* për ta çuar deri në qendrën ekzistuese të Tiranës, por kjo do të jetë një fazë tjetër.

Këtu po flasim për rehabilitimin hekurudhor Tiranë- Durrës, i cili mbështet dhe përmirëson karakteristikat gjeometrike operationale të vijës hekurudhore në përputhje me standardet e Bashkimit Europian.

Dua të shtoj diçka, që mbase në relacion nuk del qartë, pra për një asistim të mirë të trasesë së hekurudhës dhe ngritjes së shpejtësisë së trenave deri në shpejtësitë normale, pra për distanca të shkurtra deri në 100 kilometra në orë të trenit dhe për distanca më të gjata deri në 120 kilometra në orë.

Objekti i përgjithshëm i projektit është përmirësimi i sistemit të transportit, por do të doja të ndaloja në dy elemente themelore, që kanë të bëjnë me vlerësimin e projektaktit në raport me programin politik të Këshillit të Ministrave.

Ky relacion që paraqesim sot është i mbështetur në aktet ekzistuese për miratimin e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020, është në përputhje me të gjithë masterplanin, është botuar në Fletoren Zyrtare, si dhe në synon përmirësimin e strukturës hekurudhore nëpërmjet rehabilitimit të linjave ekzistuese dhe linjave të reja ndërlidhëse, sikurse është zgjerimi i TENT për hekurudhat e rrjetit bazë në Ballkanin Perëndimor, kryesisht rruga 2 që është Podgoricë- Durrës-Tiranë. Ne kemi ndërtuar një stacion *one stop shop* që është i pari dhe i vetmi në Ballkanin Perëndimor në pikën e kalimit kufitar hekurudhor midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Kjo bën të mundur që rehabilitimi i kësaj linje Tiranë- Durrës dhe faza e dytë që ne do ta fillojmë shumë shpejt, Tiranë Podgoricë- Han i Hotit do ta fusë sistemin tonë hekurudhor në linjën ndërkombëtare të sistemeve hekurudhore. Gjithashtu, mbështetet edhe në akte të tjera, sikurse është Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë, i cili është i përafëruar me *acquis communautaire* të BE-së. Në fakt, ky akt nuk shënon një afrim të mëtijshëm, pasi ka ndodhur një afrim paraprak deri në këtë moment. Vlerësimi i shkallës së përafërimit, thamë që nuk ka ndonjë të re në këtë mes. Kemi, gjithashtu, në relacion edhe një tabelë mbështetëse, që është raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, ndarja sipas grantit të BERZH-it dhe grantit të Bankës Botërore, si dhe të parave që vë qeveria shqiptare, ku përfshihen: punimet civile; projekti i detajuar me të gjithë dokumentacionin e tenderit, mbështetja për mbikëqyrjen e punimeve, implementimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale, si dhe shpronësimi i tokave. Pjesa e shpronësimit të tokave do të përqendrohet kryesisht në linjën Qafa e Kasharit- Rinas ku traseja është e re.

Doja të theksoja që granti për të cilin jemi mbledhur sot është 35 milionë e 435 mijë euro, akordohet nga Banka Europiane për Zhvillim dhe do të përdoret për financimin e punimeve për

rehabilitimin dhe rindërtimin e linjës së re. Ndërsa projekti i detajuar dhe i financuar nëpërmjet grantit të akorduar më parë të Bankës Botërore është në vlerën 1 milion e 215 mijë euro. Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të ministrisë sonë, për periudhën përkatëse dhe mbështetur me programin e transportit hekurudhor.

Nëse këtu relatori i çështjes ose anëtarët e nderuar të komisionit do të kenë pyetje, jemi në dispozicionin tuaj.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Zoti Leka.

Edmond Leka- Faleminderit!

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së grantit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit për hekurudhat shqiptare. Kjo marrëveshje synon zbatimin e projektit të detajuar për rehabilitimin e hekurudhës Tiranë- Durrës dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore me aeroportin e Rinasit, hartuar në bazë të marrëveshjes së grantit në datën 13 mars 2015, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe BERZH-it, si administrator i fondeve grant të siguruara nga qeveri të ndryshme nën fondin e përbashkët europian të Ballkanit Perëndimor.

Objektivat kryesorë në drejtim të rezultateve lidhen me rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore nga stacioni qendror hekurudhor i Durrësit deri në vendndodhjen e ardhshme të terminalit të transportit publik të Tiranës, një gjatësi rreth 34 kilometra dhe, gjithashtu, për të ndërtuar një linjë të re hekurudhore, që lidh linjën kryesore me aeroportin e Rinasit, një gjatësi rreth 4,7 kilometra.

Projekti parashikohet të përfundojë më 31 dhjetor të vitit 2020, granti në shumën 35 milionë e 435 mijë euro do të akordohet nga BERZH-i dhe do të përdoret për financimin e punimeve për rehabilitimin e linjës ekzistuese, ndërtimin e linjës së re, shërbimin e mbikëqyrjes, mbikëqyrjen e punimeve, si dhe mbështetjen për zbatimin e projektit.

Në aspektin ligjor dhe procedural është propozuar në përputhje me Kushtetutën dhe është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Kush ka pyetje?

Tom Doshi – Në rregull, hekurudhën po e ndërtojmë, po për trenat a është parashikuar të blihen të rinj? Sepse, në fakt, nuk kemi trena.

Artan Shkreli ?– Sa u përket trenave, është një fazë e dytë, për të cilën kemi filluar punën dhe do ta zhvillojmë më tej. Investimi për blerjen e mjeteve lëvizëse nuk mund të futej në këtë paketë, kështu që do të shfrytëzohen paketa të tjera. Sigurisht, do të vendosen trena të rinj të tipit modern, ata që quhen njësi multifunksionale vetëlëvizëse.

Kështu që, kur të mbarojë pjesa e ndërtimit të hekurudhës, e cila do të zgjasë rreth 3 vjet gjatë kësaj kohe, do të punohet edhe për blerjen e këtyre mjeteve lëvizëse, lokomotiva dhe vagonë.

Tom Doshi- Kam një pyetje për zëvendësministrin. Thatë që do të jetë shumë i rëndësishëm stacioni që lidh Malin e Zi dhe Shqipërinë, por hekurudha Han i Hotit-Tiranë si është parashikuar?

Artan Shkreli - Në këtë moment jemi duke bërë projektin e detajuar, pra fizibiliteti është miratuar, gjithashtu jemi në fazat e fundit të këtij projekti prej 4,5 milionë eurosh. Bëhet fjalë për një grant, i cili i hap rrugë rehabilitimit të hekurudhës së Hanit të Hotit. Ne shpresojmë që brenda vitit të ardhshëm të kemi siguruar financimin për fillimin e punimeve të rehabilitimit të kësaj linje kaq të rëndësishme. Ndërkohë, po merremi me përfundimin e fizibilitetit të hekurudhës Pogradec-Lin-Mal i Zi.

Ulsi Manja – A ka pyetje të tjera?

Tom Doshi – Ju e dini se kanë ndodhur disa aksidente te mbikalimet, a keni parashikuar gjë për mbikalimet?

Artan Shkreli – Po ia lë fjalën teknikut, i cili është marrë në nmënyrë të veçantë me pjesën e *interchange*-ve të hekurudhës.

Enea Karakaçi – Kjo pyetje, e bërë nga zoti Doshi, është shumë e drejtë dhe e saktë.

Lidhur me projektin Tiranë –Durrës, që është projekti i parë i hartuar sipas standardeve europiane, është parashikuar pjesa e sinjalistikës dhe e interlokucionit, e cila është sipas standardeve. Në nivel horizontal ndërhyhet në rrugët urbane ose interurbane, të cilat do të implementohen sipas standardeve. Do të jetë e gjitha e centralizuar nga një ambient, cili do të funksionojë vetëm për këtë pjesë.

Ulsi Manja- A ka pyetje të tjera?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka- Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Nuk e kuptoj pse qeshni! Kemi votuar edhe Kodin e Etikës dhe rezolutën për barazinë gjinore. Ju e votoni rezolutën për barazinë gjinore, por, kur e kërkon fjalën një zonjë, ju doni ta merrni fjalën përpara.

Klotilda Bushka – Së pari, unë mendoj se ky projektakt është nga më të rëndësishmit që kemi diskutuar. Unë dua të përgëzoj qeverinë shqiptare dhe ministrinë përkatëse që kanë negociuar.

Mbase nuk doli këtu, por ky projekt është një nga projektet fituese. Pra, ka konkurruar me projekte të tjera nga i gjithë Ballkani Perëndimor dhe është një nga projektet, i cili ka arritur të thithë fonde të huaja për realizime të brendshme të veprave publike. Dua t’i inkurajoj, në fakt, këto praktika, sepse, për mua si deputete e Tiranës dhe kolegët e tjerë të këtij qarku, është shumë e rëndësishme përmbushja e një premtimi të dhënë tashmë prej kohësh sa i takon ndërtimit të hekurudhës Tiranë- Durrës dhe aq më tepër pjesës së hekurudhës që lidh Tiranën dhe Durrësin me aeroportin e Rinasit. Kështu që këto janë ndërtime strategjike, premtime tona të bëra realitet përballë qytetarëve.

Pavarësisht se ne i kemi fondet për ndërtimin e veprës, siç ndodh në rastin konkret për mbështetjen, zbatimin e projektit dhe për supervizimin e tij, mbetemi peng të shpronësimeve. Duke qenë se para disa kohësh kemi miratuar edhe një projektakt tjetër që kishte të bënte me fizibilitetin e hekurudhës, mendoj se atje janë marrë në konsideratë çështjet e shpronësimeve. Pyetja ime është konkrete: a kemi ne tashmë një hartë të plotë të pronarëve që shpronësohen? A kemi ne të parashikuar në buxhet pjesën e kompensimit të tyre në mënyrë që të mos bëhen pengesë për realizimin e zbatimit të projektit që të kapet afati i 31 dhjetorit të vitit 2020, siç është parashikuar në marrëveshje për ndërtimin e kësaj vepre?

Artan Shkreli- Meqenëse unë jam kryetari i Komisionit të Shpronësimeve, në ministrinë tonë mund t’ju them se kemi filluar punën e evidentimit dhe hartografimit të mapaturës ku do të bëhen shpronësimet. Bëhet fjalë për segmentin nga Qafa e Kasharit deri në Rinas dhe është një konsulent special i ngarkuar nga ministria jonë që po merret me këtë histori. Duke filluar nga janari ne po mundohemi të bëjmë një marrëveshje paraprake Edhe me Ministrinë e Financave, sepse ne mund t’i vëmë në parashikimet tona, por Ministria e Financave ka një xhep të sajën. Në këtë rast jemi në akord me kohën dhe me Ministrinë e Financave.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Zoti Çyrbja.

Jurgis Çyrbja- Faleminderit!

Sa është frekuentimi aktual i hekurudhës Tiranë-Durrës dhe si pritet të ndryshojë fluksi pas investimit të përfutur nga kjo marrëveshje?

Artan Shkreli – Po ia kaloj fjalën drejtorit, i cili është në kontakt të përditshëm me shifrat që kërkon ju.

Thimio Plaku– Faleminderit!

Sa i përket transportit të udhëtarëve, në këto momente janë shifra shumë të ulta që shkojnë deri në 5 mijë udhëtarë në vit. Nga parashikimet që janë bërë, sipas konsulentit dhe studimit, pritet që këtë linjë ta frekuentojnë deri në 50 mijë udhëtarë në muaj në linjën Durrës-Tiranë, pa parashikuar linjën drejt Rinasit, sepse është një drejtimi i ri në transportin hekurudhor. Pra, flitet për dhjetëfishim të numrit të udhëtarëve.

Ulsi Manja- Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi- Unë kam edhe një sugjerim për relacionin. Ky është një projekt shumë i rëndësishëm dhe është një nga 3 projektet fituese në samitin e Parisit. Do të ishte e nevojshme që kur flitet për përmbledhjen shpjeguese të përmbajtjes së projektit, ajo të mos jetë një paragraf. Pra, kur shpjegojmë një projekt kaq të rëndësishëm për publikun e gjerë, i cili sillet në Kuvend të Shqipërisë në Komisionin e Ligjeve dhe komisionet e tjera, nuk duhet të kemi vetëm një paragraf me gjashtë rreshta për përmbajtjen e këtij projekti.

Pyetja ime ka të bëjë me linjën e re hekurudhore që lidh Tiranën me aeroportin e Rinasit. Cilat janë pritshmëritë? A ka një studim lidhur me numrin e përfituesve? Cili është impakti që do të ketë në xhepat e qytetarëve shqiptarë, jo vetëm të Tiranës dhe Durrësit, por edhe atyre që udhëtojnë drejt aeroportit të Rinasit?

Kam edhe një sugjerim, meqenëse këtu është zoti Shkreli që është person politik, ne kemi bërë vërejtje vazhdimisht dhe përsëri e theksojmë që do të ishte mirë që në relacionet e projektligjeve që sjell institucioni juaj, i cili ka sjellë në parlament projektligje shumë të rëndësishme me një impakt të gjerë për publikun, të ketë një informacion shumë më të detajuar për ndikimin social ekonomik dhe financiar që marrëveshjet sjellin. Është bërë tashmë traditë që mjafton të jetë marrëveshje dhe Komisioni i Ligjeve është dakord. Por marrëveshjet, qofshin grant hua ose çfarëdo tjetër është mirënjohje kur është grant edhe për atë që e jep por edhe për atë që e

përfiton, duhet patjetër të keni analizën e impaktit social-ekonomik dhe financiar, mjedisor me qëllim që ne ta dimë.

Me shumë të drejtë kolegja Bushka ngriti problemin e pronësisë private. Këto gjëra duhet të përshkruhen në relacion, pra si ndikon, si është menduar të zgjidhet.

Unë do të sugjeroja, zoti kryetar, në vijim të shkresës që ju përgatitët për nivelin e përfaqësimit të ministrive në komision dhe në parlament, por edhe detyrimit që ka qeveria në kuadër të mekanizmit ndërinstitucional për monitorimin e rezolutave të planeve të veprimit të strategjive, të kërkohet që relacionet të ndryshojnë, të përmirësohen. Ne kemi detyrime të monitorojmë si përmbushen objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. E them për ju, zoti Shkreli, sepse keni të gjithë kulturën e informacionin e duhur dhe mund të jeni një model shumë i mirë si përfaqësues i ministrisë suaj për të bërë këtë lloj ndryshimi sa herë paraqiten strategjitë dhe marrëveshjet, qofshin grante, hua e të tjera.

Artan Shkreli – Keni shumë të drejtë, zonja Hysi. Ne duhet realisht t'i pasqyrojmë në relacion më mirë analizat e impaktit edhe për faktin se ne i kemi këto analiza, të cilat janë bërë, janë në relacionet tona, nuk ka pse të mos vëmë edhe paragrafë në relacionet që paraqiten pranë komisioneve, sepse ky relacion mund të përdoret për informimin e politikës dhe popullatës dhe mediave dhe të mos dalë këtu një informacion i thatë me gjithë atë punë voluminoze që institucioni ka bërë. Mendoj se do t'i kemi parasysh vërejtjet që u bën këtu.

Ulsi Manja- Po, zoti Leka.

Edmond Leka - Unë kam një pyetje për zëvendësministrin. Është jashtë tematikës, por ka të bëjë me hekurudhën. Qytetarët e Vlorës kanë vënë re që po bëhet rehabilitimi i hekurudhës Fier-Vlorë. Pyetja ime është: a do të përdoret kjo hekurudhë vetëm për transportin e mallrave apo edhe për transportin e pasagjerëve? Nëse do të shërbejë edhe për transportin e pasagjerëve, do të kishte një impakt shumë të madh për zhvillimin e turizmit në qytetin e Vlorës.

Artan Shkreli – Bëhet fjalë për një rehabilitim, i cili do të përfshijë edhe pasagjerë. Ky është motivi që ne nuk pranuan një propozim për shndërrimin e terminalit të pasagjerëve të Vlorës në një qendër arti. Meqenëse është një koncesion, po ia kaloj fjalën zotit Plaku, i cili është më në dijeni të termave.

Thimio Plaku- Siç e tha edhe zoti Shkreli, ky koncesion nuk do të jetë thjesht për transportin e mallrave, por edhe të pasagjerëve. Me sistemin e ri të ndarjes hekurudhore, infrastruktura hekurudhore ndahet nga operimi. Kjo do të thotë që koncesionari ka në zotërim

infrastrukturën, të cilën ai po e operon. Në këtë linjë hekurudhore kanë të drejtë të operojnë kundrejt licencimit dhe tarifave të përcaktuara më parë, edhe operatorë të ndryshëm, pasagjerë, mallra të të gjitha llojeve. Kështu, kjo linjë është e hapur edhe për pasagjerët.

Unë desha të theksoj këtu edhe diçka tjetër, duke e lidhur me zhvillimin e transportit të pasagjerëve në bregdetin tonë. Po kryhet edhe një studim. Përveç studimit për projektin Vorë - Han i Hotit, po kryhet një studim i detajuar për linjën Durrës - Rrogozhinë – Pogradec - lidhja me Maqedoninë. Pjesa e parë, ku mendohet të bëhet ndërhyrja, do të jetë në seksionin Durrës-Rrogozhinë për të cilin po kryhet projekti paraprak, i cili do të krijojë mundësinë të aksesohet e gjithë kjo zonë bregdetare e plazheve (Golem, Rrogozhinë, Kavajë etj.), edhe me transport hekurudhor. Pra, do të kemi linjën Tiranë-Durrës të rehabilituar dhe lidhjen e re hekurudhore me Aeroportin e Rinasit.

Njëkohësisht, në një stad tjetër, rehabilitimin e rrugës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë, sipas të gjitha parametrave, ku mendohet se do të gjenerohet një trafik i konsiderueshëm udhëtarësh, veçanërisht për synime turistike.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Plaku!

Në fakt kur miratuam në legjislaturën që iku Kodin Hekurudhor, u tha se po miratojmë një kod me standardet më të larta europiane, po ku e kemi rrjetin hekurudhor dhe trenat? Ja që punët vijnë me radhë. Fillimisht, miratuam Kodin Hekurudhor dhe tani, po shohim investimet për rrjetin hekurudhor. Sigurisht, do të vijnë edhe trenat, sepse transporti hekurudhor është një transport i leverdishëm për qytetarët dhe është një mënyrë alternative e transportit publik në Shqipëri sot. Pse jo, edhe për të lehtësuar edhe jetën e qytetarëve. Besoj se nuk ka diskutime nga deputetët. Për këtë arsye, dua të kaloj në votimin e projektligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti Doshi për një ndërhyrje të fundit!

Tom Doshi – Hekurudha nuk është siç janë rrugët, që bëhen me akse, pra nëse bëhet fjalë që të bëhet rehabilitimi i rrjetit hekurudhor, ai duhet të bëhet të paktën nga Hani i Hotit deri në Tiranë. Nuk mund të bëhen akse të tilla. Këta sot kanë ardhur të papërgatitur për të gjithë rrjetin hekurudhor shqiptar. Këta kanë ardhur vetëm për një marrëveshje ...

Ulsi Manja – Këta kanë ardhur për një marrëveshje për linjën Tiranë Durrës.

Tom Doshi – Ju e keni shumë merak linjën Tiranë -Durrës. Faktikisht, këtu është qendra më e madhe e banimit, por duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Shameti, të përfundojë edhe kolegu Doshi!

Tom Doshi – Nuk duhet lënë pas dore dhe Veriu. E mira është, që ju të bëni një studim për të gjithë rrjetin hekurudhor shqiptar.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Doshi!

Urdhëroni, zoti Plaku për një përgjigje për pyetjen e zotit Doshi!

Thimio Plaku – Desha të sqaroj, se kemi një studim të plotë për të gjithë rrjetin hekurudhor shqiptar, ku siç ju thashë, linja hekurudhore ndërkombëtare me Malin e Zi, do të fillojë menjëherë mbas linjës Tiranë-Durrës. Presim vetëm që projekti të maturohet në kuptimin e hartimit të projektit të detajuar dhe të vlerësimit ambientat. Më pas me këtë projekt do të shkojmë në samitet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ku do të aplikojmë për grant për gjysmën e financimit (në mënyrë shumë të ngjashme me këtë projekt), për rehabilitimin e kësaj linje hekurudhore.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Plaku!

Është normale të fillojë nga Hani i Hotit, sepse ajo është e vetmja portë hyrëse dhe lidhëse jona me rrjet hekurudhor me Malin e Zi dhe me Europën, sepse nga Hani i Hotit lidhemi me hekurudhë me Europën dhe më pas kur vjen poshtë, nuk ka më na lidh, vetëm, sipas studimit të projektit të ri lidhja me Maqedoninë.

Ju lutem, zoti Doshi!

Tom Doshi – Kam edhe një ndërhyrje. Sipas specialistit që ka ardhur këtu të prezantojë projektin, thuhet se mbasi të bëjmë studimin dhe projektin, do të dalim të lypim lekë borxh. Domethënë, qeveria nuk ka fonde për këtë punë, megjithëse Ulsiut i intereson politikisht të thotë se është bërë një punë e madhe, por ju nuk paskeni siguruar akoma lekët për investimin. Mbasi t'i kryeni këto punë, do të drejtoheni nëpër Ballkan për të kërkuar lekë borxh?

Ulsi Manja – Jo në Ballkan, se Ballkani nuk ka lekë për vete. Ka Europa lekë sa të duash. Mjafton të kemi projekte të mira dhe konkurruese, si ky që kemi sot mbi tryezë. Shqipëria ka mjaftueshëm kapacitete për të bërë projekte. Po të kishte lekë Ballkani, do t'i kishte bërë me kohë hekurudhat dhe punët e tjera.

Zoti Shkreli, ju lutem një përgjigje të shkurtër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Shkreli – Gjithsesi, bëhet fjalë për një shifër relativisht të lartë për xhepat e buxhetit të shtetit. 170 milionë euro është shuma për rehabilitimin e hekurudhës deri në Han të Hotit, i cili

mendohet ashtu si ky projekt, që gjysmën ta ketë grant dhe gjysmën ta ketë hua. Gjysma e shumës 170 milionë euro grant është realisht një shifër për të cilën ia vlen të dalim me trastë nëpër Europë. Është një gjë, që kemi shumë besim se do ta fitojmë, sepse edhe Europa është e interesuar në këtë rast. Bëhet fjalë për një lidhje me të dhe nuk bëhet fjalë për një rrjet të brendshëm hekurudhor, sikurse është linja Tiranë - Durrës, për të cilin natyrisht, interesi i tyre është më i ulët.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shkreli!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kalojmë në votimin në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët European i Ballkanit Perëndimor””.

Kush është pro në parim? Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim kjo marrëveshje.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, në kuadër të grantit të investimit nga Fondi i Përbashkët European i Ballkanit Perëndimor”.

Edhe kjo marrëveshje së bashku me marrëveshjet e tjera, që sapo kaluam në Komisionin e Ligjeve, do të kalojë për në seancë. Ftoj relatorët që së bashku me këshilltarët të përgatisin materialet për në seancë për t'i votuar nga kolegët deputetë.

Me këtë pikë të fundit të rendit të ditës e mbyllim mbledhjen e komisionit.

Faleminderit!

Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

Edhe një herë, faleminderit!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA